

PROCESVERBAL
nga seanca e 13-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 24.03.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 13-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 19.03.2025.
2. Propozim-raport vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.
3. Propozim-qëndrim i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në lidhje me rezultatin e revizionit të kryer nga revizor i pavarur për vitin 2024.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 19.03.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajčevski shpjegoi Propozim-raportin vjetor të punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024. Ai theksoi se në krahasim me Draft-versionin, në Raport janë bërë dy ndryshime. Ndryshimi i parë është në faqen 7, ku është hequr një paragraf që i referohej iniciativës së Agjencisë për ndryshime në dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për përqendrim të paligjshëm mediatik, sepse të njëjtat informacione ishin përsëritur në dy vende në hyrje. Ndryshimi i dytë, gjithashtu në faqen 7, i referohet korrigjimit të të dhënave për numrin e seancave të mbajtura të Këshillit – në vend të numrit 62, në verzionin e ri thuhet se janë mbajtur 63 seanca. Në pjesën tjetër të Raportit nuk ka ndryshime.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për miratimin e Raportit vjetor të punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024 (Raportin për realizimin e planit vjetor për mbikëqyrje programore për vitin 2024 dhe Raportin financiar për realizimin e planit financiar për vitin 2024 dhe llogarinë vjetore me të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara për vitin 2024), me tekstin e propozuar.

Agjencia duhet të veprojë në përputhje me nenin 8 paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20,77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24) dhe nenit 11 paragrafi (2) të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.07.2019.

Pika 3

Z. Trajčevski shpjegoi Propozim-qëndrimin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në lidhje me rezultatet e revizionit të kryer nga revizor i pavarur për vitin 2024. Ai shpjegoi se pas zbatimit të furnizimit publik është përzgjedhur një firmë revizioni, e cila ka kryer revizionin e punës financiare të Agjencisë për vitin 2024. – Qëndrimi i propozuar i ASHMA-së është se Agjencia pajtohet me të gjitha konstatimet e revizionit, përveç një pjese – 'Bazë për mendim me rezervë', që i referohet vlerës së trualtit nën ndërtesë. Kjo pronë është përfshirë në bilanc me rekomandimin e Entit Shtetëror të Revizionit, që është dhe arsyeja e mosmarrëveshjes. Njëkohësisht, qëndrimet e Entit Shtetëror të Revizionit dhe revizionit të pavarur që ka kryer revizionin e punës së Agjencisë për vitin 2024 janë diametralisht të kundërta. Si organ shtetëror, Agjencia vepron në përputhje me konstatimet, vërejtjet dhe qëndrimet e Entit Shtetëror të Revizionit.

Z. Trajčev theksoi se kjo situatë është përsëritur që nga viti i kaluar – nga njëra anë Enti Shtetëror i Revizionit tregon se toka duhet të përfshihet në bilanc, ndërsa nga ana tjetër revizorët e pavarur konsiderojnë se kjo nuk është e nevojshme. Lidhur me këtë, ai pyeti nëse ka mundësi që të dorëzohet Informacion në Qeveri dhe të kërkohet që toka nën ndërtesë të regjistrohet dhe të transferohet si pronë e Agjencisë? Në këtë mënyrë do të kapërceheshin qëndrimet e kundërta të dy revizioneve dhe do të përcaktohej se cila është mënyra e duhur e veprimit, e cila përfundimisht do ta mbyllte këtë çështje.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit – Shefe e kabinetit, dr.Dragica Ljubevska, sqaroi se Agjencia këto pyetje i ka parashtruar që në fazën e regjistrimit të pronës në Kadastrin e RMV-së. Në këtë drejtim janë zhvilluar takime me

autoritetet për marrëdhënie pronësore-juridike, Ministrinë e Financave, Sektorin për Menaxhimin e Borxhit Publik. Në ato takime është theksuar se e gjithë pasuria e organeve shtetërore, përfshirë edhe institucionet publike, menaxhohet si pronë shtetërore. Përgjashtim nga ky rregull është i mundur vetëm nëse në një ligj të veçantë, të specializuar (lex specialis) thuhet qartë se organ i caktuar ka të drejtë të disponojë me pasuri të paluajtshme. Duke qenë se Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele thotë se Agjencia nuk mund të disponojë me pasuri të paluajtshme, nuk duhet të bëhet përgjashtim. Megjithatë, pavarësisht takimeve të shpeshta për këtë temë, rezultati mbetet i pandryshuar – në fletën (aktin) e pronës shkruhet se shteti disponon me pasurinë e paluajtshme dhe tokën.

Këshilli i Agjencisë, në lidhje me rezultatet e revizionit të kryer për vitin 2024 nga Shoqëria për Revizion dhe konsulencë biznesi A&BA GROUP SHPKNJP Shkup, njëzëri përcaktoi qëndrimin në vijim të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele:

- Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele pajtohet me mendimin e Raportit të Revizionit për vitin 2024, i vërtetuar në Arkivin e Agjencisë me numër 03-1034/2 datë 18.03.2025, se Raportet financiare përfaqësojnë objektivisht në të gjitha aspektet materiale gjendjen financiare të Agjencisë me datën 31.12.2020.

Në lidhje me pjesën “Bazë për mendim me rezervë” që i referohet vlerës së trualtit nën ndërtesë, Agjencia nuk pajtohet, për arsye se e njëjta është futur në bilanc me rekomandim të Entit Shtetëror të Revizionit.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Qëndrimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**